

Raporti Vjetor i RrGGK 2014

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, dhjetor 2014

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke u cituar autorët. Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Kvinna till Kvinna dhe Austrian Development Agency. Qëndrimet në këtë publikim janë qëndrime të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës dhe nuk paraqesin në asnjë mënyrë mendimet e Kvinna till Kvinna dhe Austrian Development Agency.

www.womensnetwork.org

Printuar në letër të riciklueshme nga Night Design në Prishtinë, Kosovë.

Printuar me mbështetjen e:

 Austrian
Development Cooperation



Kvinna till Kvinna

Raporti Vjetor i RrGGK 2014



PËRMBAJTJA

LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RrGGK.....	4
HYRJE	7
Rreth Raportit Vjetor të RrGGK.....	8
NGRITJA E KAPACITETEVE TË RrGGK.....	9
Sigurimi i një komunikimi dhe bashkëpunimi të rregullt dhe të vazhdueshëm mes anëtareve të RrGGK dhe palëve tjera të intersit	10
Përmirësohen kapacitetet institucionale të RrGGK dhe anëtareve të saj drejt ngritjes së kapaciteteve avokuese dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit	16
Rritet bashkëpunimi mes grave në rajon (dhe më gjërë) drejt drejtësisë tranzicionale, paqes dhe sigurisë.....	22
RRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIM-MARRJE.....	24
Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendim-marrje në nivel komunal dhe kombëtar	24
Në vitin 2014, RrGGK ka fuqizuar dhe ka inkurajuar më shumë gra të kandidojnë për pozita vendim-marrëse në nivel komunal dhe kombëtar.	24
PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESHIN SHËNDETËSOR CILËSOR.....	33

Përmirësimi i qasjes së grave në kujdesin shëndetësor cilësor	33
JETA PA DHUNË NË FAMILJE DHE TRAFIKIM	35
Rritet vetëdija publike për legjislacionin dhe mënyrat se si të kërkohet ndihma	35
MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE.....	37
Përmirësohet gradualisht pozita ekonomike e grave në Kosovë.....	37
Përmirësohet qasja e grave në prona (dhe kështu edhe në kapital), në përputhje me të drejtat e tyre ligjore	38
Iniciativa të rëndësishme: RrGGK lansoi Strategjinë e re.....	40
VLERËSIMI I PUNËS SË RrGGK.....	41
Përparimi drejt përmbushjes së Planit Strategjik të RrGGK 2011-2014, në vitin 2014.....	42
RAPORTI FINACIAR I RrGGK PËR VITIN 2014	53
PËR NE	61
Organizatat Anëtare të RrGGK	66
Shtojca 1. Grantet e Fondit të Grave të Kosovës në vitin 2014.....	72
Shtojca 2. Të arriturat e avokimit nga Grupet Avokuese për Barazi Gjinore (GABGj) në vitin 2014	80

LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RrGGK

Të nderuar/a anëtar/e të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës,

Po e leme mbrapa një vit të përmbushur me punë, suksese por edhe sfida. Si përfaqësuese të denja të grave dhe vajzave kemi arritur t'i tregojmë sadopak vendimmarrësve se cilat janë nevojat dhe interesat e grave në procese të ndryshme që po kalon Kosova. Meqë gratë dhe vajzat janë një grup divers, konstant i ndryshueshëm në bashkëbisedim të ngushtë me to, kemi arritur që t'i identifikojmë mënyrat më të mira për t'i fuqizuar gratë dhe t'i sjellim në proceset e rëndësishme vendimmarrëse.

Do të veçoja Fondin e Grave të Kosovës si një projekt të përzgjedhur dhe punuar me shumë kujdes. Projekte të tilla si përkrahja e lëvizjes së lirë të grave me nevoja të veçanta që me vite nuk kanë pasur qasje në institucionet publike për shkak të mungesës së pjerrinave në Komunën e Prizrenit; pastaj reflektimi i perspektivës gjinore në proceset vendimmarrëse komunale si në Komunën e Novobërdës kur për herë parë u reflektuan kërkesat e grave në buxhetimin komunal; si dhe punësimi i grave në Dragash pas trajnimeve të marra nga përkrahja e Fondit të Grave, ka mundësuar që gratë të dalin nga sfera private familjare në sferën publike me anë të punësimit. Të gjitha këto janë bërë me anë të një përkushtimi të stafit dhe punës së përgjegjshme të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) por



më tepër nga puna e pandërprerë dhe e përkushtuar e vetë anëtareve të RrGGK-së. Nënshkrimi dhe vazhdimi i kontratës për tre vite lidhur me Fondin e Grave të Kosovës ndërmjet RrGGK dhe Austrian Development Agency (ADA) e tregon se një përkushtim i tillë i vazhdueshëm është vlerësuar dhe RrGGK është parë si një partner kryesor dhe strategjik për përfaqësimin e grave dhe vajzave në Kosovë.

Do të veçoja poashtu edhe hartimin dhe lansimin e fundit të Strategjisë së RrGGK për vitet 2015-2018. Duke identifikuar sfidat e ndryshme reale me të cilat po ballafaqohen gratë sot në Kosovë në komuna, fshatra dhe qytete me statuse dhe nevoja të ndryshme, RrGGK do të vazhdon që me hapa të vegjël por të sigurtë të përkrah dhe avokoj për realizimin e potencialit të plotë të grave dhe vajzave. Nga avokimi për fuqizimin ekonomik të grave dhe qasjen e grave në burimet ekonomike; avokimi për kujdesin shëndetësor kualitativ dhe me qasje të lehtë për gratë dhe vajzat; si dhe avokimi që gratë në politikë dhe vendimmarrje të përfaqësojnë me dinjitet interesat dhe nevojat e grave duke kërkuar që dhuna ndaj grave të dënohet si formë e cila vazhdon të mbaj gratë në sferën private dhe të mbaj pushtetin familjar dhe real në vendimmarrje me anë të dhunës së ushtruar.

Një shoqëri ku gratë dhe vajzat kanë mundësinë të realizojnë potencialin e tyre të plotë në të gjitha sferat dhe të japin kontributin e tyre në ndarjen dhe shpërndarjen e resurseve shoqërore në mënyrë të barabartë duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e çdo individi, mbetet një moto për punë të vazhdueshme dhe të pandalshme të RrGGK edhe për vitet që po vijnë. Kosova ka edhe shumë çmime



të merituar dhe të denja të ofroj për shoqërinë tonë sikurse Majlinda Kelmendi, nëse do i japim mundësinë që vajzat të shprehin potencialin e tyre të plotë.

Ju dëshiroj suksese dhe punë të vazhdueshme dhe të përgjegjshme edhe në vitin që po vjen, me dëshirën që motoja jonë të bëhet realitet.

Sinqerisht,

Ariana Qosaj-Mustafa

Kryetare e Bordit

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës



HYRJE

Vizioni i RrGGK

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) parasheh që në shtetin e Kosovës gratë dhe burrat të jenë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Misioni i RrGGK

Misioni i rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual dhe aftësitë. RrGGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe të shërbimeve.

Strategjia e RrGGK

Për të përmbushur këtë mision, RrGGK ka hartuar Planin Strategjik për periudhën 2011-2014. Qëllimi i kësaj strategjie është që të drejtojë punën e RrGGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, bordi drejtues, partnerët dhe palët tjera relevante. Kjo strategji e RrGGK-së është e ndarë në pesë fusha programatike: I) Ngritja e kapaciteteve të RrGGK; II) Gratë në politikë dhe vendim-marrje; III) Shëndeti i grave; IV) Dhuna në familje dhe trafikimi; dhe V) Fuqizimi ekonomik i grave. Anëtarët e rrjetit kanë identifikuar këto si fushat kryesore në të cilat RrGGK duhet të fokusohet më shumë.

Rreth Raportit Vjetor të RrGGK

Çdo vit rrjeti raporton te anëtarët e veta, te partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport fillestar, i përgatitur për kuvendin vjetor të anëtareve të RrGGK-së, që mbahet në dhjetor të vitit 2014, përmban informata lidhur me aktivitetet e RrGGK nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2014. Ky raport është i ndarë në pesë pjesë në të cilat përfshihen objektivat afatgjata të rrjetit:

- Ngritja e kapaciteteve të RrGGK-së
- Mbështetja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në vendim-marrje
- Pëmirësimi i qasjes së grave në kujdes shëndetësor
- Zvogëlimi i dhunës në familje dhe trafikim
- Mbështetja për fuqizimin ekonomik të grave

Në këtë raport, prezantohen të arriturat dhe rezultatet për vitin 2014. Gjithashtu, reflekton të arriturat në Planin Strategjik 2011-2014, i cili përfundon këtë vit. Në fund, raporti përmban informata rreth buxhetit, mbështetësve, bordit drejtues, bordit këshillëdhënës, stafit, praktikanteve, vullnetareve dhe anëtareve.



NGRITJA E KAPACITETEVE TË RrGGK

Qëllimi kryesor i programit për ngritjen e kapaciteteve të RrGGK është që grupet dhe organizatat e grave në Kosovë, rajon dhe më gjërë, të kenë bashkëpunim dhe komunikim të rregullt, si dhe të organizohen kur janë në pyetje çështjet me interes të përbashkët. Gjatë vitit 2014, RrGGK kishte arritur këto rezultate, që kontribuan në arritjen e këtij qëllimi, siç ishte paraparë në Planin Strategjik:



Anëtarët dhe stafi i RrGGK, gjatë takimit në Durrës, Shqipëri, me 7-10 nëntor.

Sigurimi i një komunikimi dhe bashkëpunimi të rregullt dhe të vazhdueshëm mes anëtareve të RrGGK dhe palëve tjera të intersit

RrGGK siguroi komunikim dhe bashkëpunim të rregullt dhe të vazhdueshëm mes anëtareve të saj dhe palëve tjera të interesit përmes takimeve të rregullta rrjetëzuese. Takimet vjetore krijuan një hapësirë të sigurtë për gratë aktiviste për të diskutuar çështje të rëndësishme të sigurisë për ato dhe tema të ndryshme tabu, si dhe për të reflektuar e ndërtuar solidaritet.

Anëtares e RrGGK të informuara me iniciativat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGGK, mundësitë e financimit, si dhe informata të tjera të dobishme

RrGGK ka organizuar pesë takime dymujore të anëtareve dhe një takim vjetor në Durrës përmes të cilave 388 anëtare, partnerë dhe përkrahës të ndryshëm kanë shkëmbyer informata; u organizun së paku pesë iniciativa të përbashkëta; dhe u informuan për aktivitetet që po zhvilloheshin në vazhdimësi nga RrGGK dhe nga organizatat tjera. Gjatë takimeve, anëtares e RrGGK-së kontribuan në planifikimin e Strategjisë së re të RrGGK-së 2015-2018, zbatimin e strategjisë egzistuese dhe monitorimin e vlerësimit e punës së RrGGK-së. RrGGK poashtu ka organizuar takimin vjetor ku u diskutua për arritjet e sfidat e vitit 2014.




Puna e RrGGK dhe e anëtareve të saj më e promovuar tek partnerët potencial, tek aktivistet e grave në mbarë botën dhe tek përkrahësit potencial

RrGGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të RrGGK-së, faqen e Facebook-ut, dhe buletin elektronik mujor *Zëri i Grave Kosovare*. RrGGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 94 sa ishin në vitin 2012 në 3,995 në vitin 2014. Në Facebook është mbyllur grupi i Iniciativës për Fuqizimin e Vajzave dhe është zëvendësuar me një faqe tjetër që ka 1,568 ndjekës. Ky ndryshim ka ardhur pas kërkesës së anëtareve të atij grupi në mënyrë që informatat të shpërndahen më lehtë. Së fundmi, RrGGK ka hapur një faqe tjetër në Facebook të emërtuar “FemACT” që së shpejti do ta zëvendësoj Iniciativën për Fuqizimin e Vajzave. Kjo faqe tani ka 370 ndjekës. Gjithashtu, RrGGK menaxhon faqen e re “Lobi për Barazi Gjinore” që ka 360 ndjekës.

Gjatë vitit 2014, RrGGK kishte 40,601 vizitorë në faqen e saj të internetit dhe 20,186 vizitorë unik. Sa i

përket ndërvëprimit me faqen e internetit të RrGGK-së (“të klikuarit përreth”), ishin **525,363** klikime. RrGGK ka shpërndarë përmes e-mailit dhe Facebook-ut, informata për punën e anëtareve të saj më



Grafiku 1. Ndjekësit e faqes së RrGGK në Facebook gjatë vitit 2014 sipas moshës dhe gjinisë

shumë se 21 herë gjatë vitit 2014. RrGGK poashtu ka shkruar artikuj për punën e anëtareve në buletinin mujor *Zëri i Grave Kosovare*, i cili lexohet kudo nëpër botë. RrGGK është përpjekur që të gjitha publikimet dhe shumë prej informatave të publikuara në internet (shpeshherë edhe me mungesë të fondeve për përkthim) t'i ketë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.

Një mënyrë tjetër, përmes së cilës RrGGK synon të kontribuojë në dukshmërinë e anëtareve të saj është Iniciativa e Historisë Gojore e Kosovës. Kjo iniciativë përfshin gra të gjeneratave të ndryshme, kombësive dhe lëmive të llojllojshme, misioni i së cilës është të regjistrojë histori të jetës së kosovarëve. Është inicuar si bashkëpunim mes RrGGK-së dhe *New School for Public Engagement* (NY). Faqja e internetit, <http://oralhistorykosovo.org/sq/>, u lansua në maj të vitit 2014. Kjo faqe e internetit përmban intervista të xhiruara; transkriptat në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe; rrëfime të shkurta; dhe fotografi që paraqesin jetën e përditshme të personave të intervistuar.



Nadire Dida njëra nga mësueset e para në Prishtinë

Kumtesat e dërguara për media nga RrGGK në vitin 2014

1. One Billion Rising (Një Miliardë në këmbë) (14 shkurt)
2. Rivendosja e fotografive të të pagjeturve (8 mars)
3. RrGGK shpreh ngushëllime me rastin e vdekjes së Dr. Gani Demolli (18 mars)
4. RrGGK dënon dhunën e ushtruar ndaj të moshuarës Xhyllë Dërguti në KK Skënderaj (24 mars)
5. Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës publikon raportin Buxhetimi për Mirëqenien Sociale (1 korrik)
6. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së, anëtare e Grupit Këshillues të Kombeve të Bashkuara lidhur me Rezolutën 1325 (7 gusht)
7. RrGGK dënon krimin e dyfishtë në Suharekë (25 gusht)
8. “Gratë bëjnë thirrje për paqe” në gjithë botën (19 shtator)
9. Reagim për tekstin në librin e Profesor Vesel Latifit (20 tetor)
10. Shënohet 14 vjetori i Rezolutës 1325 (31 tetor)
11. RrGGK lanson Strategjinë e re 2015-2018 dhe shfaq Dokumentarin për Fondin e Grave të Kosovës (20 nëntor)
12. Themelohet Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë (21 nëntor)
13. Forumi Feminist FemACT organizon marshim kundër ngacmimeve seksuale në hapësira publike si pjesë e fushatës #TakeBackTheNight (27 nëntor)
14. RrGGK dhe ADA nënshkruan kontratën tre vjeçare për avancimin e të drejtave të grave (28 nëntor)
15. Prona nuk ka gjini, ka trashëgimtarë! (2 dhjetor)
16. RrGGK është me Shyhreten dhe me Rektorin (6 dhjetor)
17. Lobi për Barazi Gjinore i pakënaqur dhe i zhgënjyer me numrin e grave përfaqësuese në qeverinë e re

Të gjitha letrat dhe deklaratat për shtyp janë në dispozicion në faqen e internetit të RrGGK.



Më shumë aktiviste të reja të përfshira në RrGGK, FemACT

RrGGK ka angazhuar 323 vajza të reja në lëvizjen e grave të Kosovës dhe më gjërë që nga viti 2011. Iniciativa për Fuqizimin e Vajzave, Forumi i Feministeve të Reja, Shkolla Verore Feministe (shih më poshtë) dhe ofrimi i mundësive për kryerjen e punëve praktike për vajza që janë fuqizuar si vajza udhëheqëse.

Në vitin 2014, pjesëmarrëset në Iniciativën për Fuqizimin e Vajzave të përkrahura nga RrGGK, vendosën ta ndërrojnë emrin e grupit në FemACT, me moton: “Diskutojmë, por edhe veprojmë.” Emri i tyre synon të sjellë fjalën feminizëm në organizimin e tyre, dhe njëherit të krijojë hapësirë për djemtë të cilët përkrahin feminizmin që t’iu bashkangjiten në përpjekjet për të arritur barazi gjinore. FemACT vazhdoi takimet konsultuese me vajzat dhe djemtë në pesë komuna: Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren dhe Gjakovë. Këtë vit, bazuar në të dhënat egzistuese deri me 30 nëntor, edhe 45 vajza e djem iu bashkangjitën kësaj iniciative, duke e ngritur numrin e anëtarëve të FemACT në 195. Takimet rezultuan me informata për Strategjinë e FemACT për vitet 2014-2017, të cilën ata po e përdorin si platformë për avokim të përbashkët. Të gjitha objektivat, aktivitetet dhe indikatorët brenda strategjisë janë identifikuar

“Po ju shkruaj sepse dua të ju përgëzoj për punën që po bëni. Përgëzime për kurajon që po tregoni. Ju po na bëni të ndihemi të motivuar. Më ka pëlqyer shumë idea e fushatës dhe ju dëshiroj suksese për aktivitetet që lidhen me projektin. Dua të di se si mund të bëhem anëtare e kësaj iniciative, pasi që jam shumë e interesuar të jem aktive në lëvizjen feministe.”

- Koment në Facebook



nga pjesëmarrësit e FemAct. Prandaj, edhe pse RrGGK përkrahë Iniciativën e tyre, iniciativa mbetet në duart e vajzave dhe djemve. Grupet e aktivistëve të rinj janë të angazhuar në shumë iniciativa në nivel lokal.

Nga 29 nëntor deri më 1 Dhjetor, 59 vajza dhe djem anëtarë të FemACT u mbledhën në përvjetorin e dytë të Forumit Feminist për të planifikuar iniciativa avokuese dhe për të avokuar drejtëpërdrejtë tek zyrtarët lidhur me çështjet e identifikuara si prioritate për vajzat.



Anëtarët e FemACT u mbledhën për forumin e dytë feminist me 29 nëntor deri me 1 dhjetor.

Kjo përfshin edhe organizimin e iniciativës #TakeBackTheNight për herë të parë në Kosovë, duke përdorur rrjetet sociale dhe duke organizuar një marshim për të nxitur debat publik lidhur me ngacmimet seksuale dhe ato në rrugë që rrezikojnë vajzat. Iniciativa ndezi debate e diskutime të nxehta nga shumë njerëz në media dhe rrjete sociale. Përveç FemACT, RrGGK poashtu ofroi mundësi për kryerjen e punës praktike për 5 vajza duke përfshirë edhe tre të tjera si vullnetare. Kjo u jep mundësi vajzave që si pjesë e lëvizjes së grave në Kosovë, të aftësohen në organizim dhe avokim.

Përmirësohen kapacitetet institucionale të RrGGK dhe anëtareve të saj drejt ngritjes së kapaciteteve avokuese dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit

Punëtoritë, mentorimi dhe Fondi i Grave të Kosovës kanë përkrahur anëtarët e RrGGK-së në fuqizimin e organizatave të tyre.

Ndërmirren hapa për rritjen e zbatimit të Kodit të Mirësjelljes në mesin e anëtareve

RrGGK vazhdon zbatimin e Planit për Ngritjen e Kapaciteteve për Anëtarët, drejt krijimit të mundësive për ato që ta zbatojnë më tutje Kodin e Mirësjelljes së RrGGK-së, dhe që të ngrisin kapacitetet e tyre.

Këtë vit RrGGK ka organizuar tetë punëtori interaktive për anëtarët e saj: Përpilimi i Manualeve të Politikave; Të kuptojmë sistemin e taksave të Kosovës; Metodatat e hulumtimit; Fuqizimi i misionit dhe vizionit të organizatës; Angazhimi i bordit të organizatës suaj; Monitorimi dhe vlerësimi; Indikatorët për matjen e ndryshimeve; Arti dhe avokimi; dhe Përfshirja e mediave. Në vitin 2014, stafi i RrGGK-së poashtu ofroi mentorim individual për së paku 70 organizata anëtare. RrGGK ka ofruar shërbime pa pagesë për anëtarët lidhur me fushën e marrëdhënieve me publikun,



Delina Fico, anëtare e Bordit Këshillues të RrGGK-së nga East-West Management Institute mentoron anëtarët e RrGGK-së në shkruarjen e misionit dhe vizionit.



përkthime, shkrim të projekt-propozimeve, buxhetim dhe menaxhim financiar.

Deri më tani, RrGGK ka vizituar 81 organizata anëtare për të evidentuar përparimet e bëra në zbatimin e *Kodit mbi Etikën dhe Përgjegjësitë e RrGGK-së*. Kjo do të përdoret për të matur përparimin e bërë në dy vitet e fundit, si dhe për të krijuar një [Plan të ri për Ngritjen e Kapaciteteve](#) për anëtarët e RrGGK-së, që do të shërbejë si udhëzues për dhënien e përkrahjes për ngritje të kapaciteteve të tyre në të ardhmen.

Anëtarët e RrGGK aftësohen për të ngritur fonde, për të planifikuar në mënyrë më efektive dhe për të ndërmarr iniciativa më efektive avokuese

Duke u bazuar në punëtoritë dhe mentorimin, dhe duke përcjellur arritjet e vitit 2013, RrGGK ka vazhduar të mbështes organizatat e saj anëtare në vitin 2014 përmes Fondit të Grave të Kosovës në zhvillimin e kapaciteteve të tyre për ngritje të fondeve, planifikim dhe avokim. Organizatat anëtare të RrGGK janë aftësuar për shkruarjen e projekt propozimeve, në krijimin dhe mirëmbajtjen e databazave të vlerësimit dhe sistemeve financiare, në shkrimin e raporteve narrative dhe financiare, realizimin e hulumtimeve, dhe planifikimin e fushatave avokuese. Për disa nga këto organizata, ishte hera e parë që kanë bërë hulumtime, kanë analizuar të dhëna, si dhe që i kanë prezantuar të gjeturat tek palët e interesit. Kjo u ka mundësuar atyre të avokojnë në mënyrë profesionale duke u bazuar në fakte.



Anëtarët e RrGGK-së krijojnë plane të monitorimit dhe vlerësimit gjatë një trajnimit të udhëhequr nga stafi i RrGGK-

Këtë vit, në Fondin e Grave të Kosovës janë dorëzuar 41 projekt propozime nga anëtarët e RrGGK. Organizatat anëtare kanë implementuar 27 iniciativa në 16 komuna të Kosovës, me përkrahjen e Kvinna till Kvinna (KtK), Austrian Development Agency (ADA) dhe Fondacioni IPKO, duke arritur shumë prej **66,338€**. Nga vjeshta e vitit 2012 deri me 31 dhjetor 2014, si rezultat i këtyre iniciativave kanë përfituar **3,433 persona**, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, personat nga zonat rurale, personat e etnive të ndryshme (turq, goranë, serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë dhe shqiptarë), të rinjë dhe pensionerë.

Fondi i Grave të Kosovës, gjithashtu ka arritur të rrisë bashkëpunimin mes organizatave anëtare të RrGGK. Këtë vit, përveq **Granteve Avokuese Individuale** (deri në 3,000 €), RrGGK ka ofruar edhe **Grante Avokimi në Partnership për Ndryshim** (deri në 8,000 €). Kjo e fundit, u jep mundësi dy organizatave të aplikojnë për një iniciativë të përbashkët. Për shembull, bashkëpunimi mes Shoqatës për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes nga



Anëtarët e RrGGK-së nënshkruajnë kontratat për grante nga Fondi i Grave të Kosovës.



Gjakova dhe OJQ Gruaja Hyjnore nga Gjlani, ka rezultuar në krijimin e një plani avokues për nivelin qëndror lidhur me lëndën mësimore të edukimit shëndetësor. OJQ-të Ruka Ruci dhe Dera e Hapur bashkëpunojnë për t'i informuar më mirë gratë mbi barazinë gjinore duke i përkrahur në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në nivel lokal.

Deri në fund të vitit 2014, përmes granteve të Fondit të Grave të Kosovës, anëtarët e RrGGK-së kanë ndërmarrë së paku 25 iniciativa avokuese dhe kanë përfshirë **1,832** gra në procese vendim-marrëse. Bashkëpunimi i frytshëm i tyre me zyrtarët për barazi gjinore dhe kryetarët e komunave iu ka mundësuar që të avokojnë me sukses dhe të bëjnë ndryshime të politikave në nivel lokal. Këto arritje ndihmuan gratë që të kenë më shumë qasje në institucione lokale, si nëpër shkolla, spitale, kuvende komunale, gjykata dhe departamente të ndryshme komunale. Në disa komuna, gratë kanë përfituar shërbime pa pagesë. Deri më tani, gjatë këtij viti, 11 iniciativa avokuese kanë arritur rezultatet e tyre të parashikuara:



1. Shoqata Hendifer avokoi te zyrtarët e kuvendit komunal në Ferizaj që spitali të ketë aparat të mamografisë me të cilin gratë mund të bëjnë kontrollat e kancerit të gjirit. Falë avokimit të suksesshëm, sot spitali i Ferizajit posedon dy aparate të mamografisë.
2. Shoqata Iniciativa e Grave avokoi te kryetari i komunës të Dragashit që të ndihmojë punësimin e vajzave në fabrikën e sapo hapur në Dragash. Prej gjithsej 33 vajzave të cilat kanë ndjekur kursin e rrobaqepësisë të Iniciativës së Grave, 24 janë punësuar në këtë fabrikë.
3. Organizata e Personave me Distrofi Muskulare me sukses avokoi tek kuvendi komunal i Prizrenit që personat me nevoja të veçanta të kenë qasje me karroca në institucionet publike.
4. OJQ Gruaja Bashkëkohore avokoi te Drejtoria e Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit që gratë e shoqatës të bëjnë kontroll falas për kancerin e gjirit gjatë gjithë vitit (jo vetëm të bëhen gjatë fushatës kundër kancerit të gjirit).
5. Më tutje, OJQ Gruaja Bashkëkohore, avokoi tek reparti i fizioterapisë në kuadër të spitalit të Prizrenit që fizioterapia për personat me aftësi të kufizuar e cila ka zgjatur vetëm 21 ditë, të zgjas dy muaj, dhe ato e arritën me sukses këtë iniciativë.
6. Avokimi i Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave ka kontribuar në adaptimin e amandamentimeve që do t'u ofrojnë shërbime dhe asistencë grave që përjetuan dhunë seksuale gjatë luftës. Ato gjithashtu u kanë ofruar të dhëna për presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga. Në këtë mënyrë ato kanë kontribuar në Këshillin e Ri Kombëtar për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale gjatë luftës.

Shih Shtojcën I ku paraqitet lista e të gjitha granteve të dhëna përmes Fondit të Granteve të Kosovës për këtë vit, si dhe arritjet e tyre deri tani. Broshura “[Grante të vogla, ndryshime të mëdha](#)” e publikuar nga RrGGK ofron më shumë detaje rreth iniciativave të tyre.

Përveq kësaj, RrGGK ka zhvilluar kapacitetet e saj të brendshme për ngritjen e fondeve. Me qëllim të sigurimit të burimeve të ndryshme për qëndrueshmëri afatgjate të rrjetit si dhe mundësisë së reagimit të shpejt për çështje që prekin të drejtat e grave në rastet kur nuk ka afat për të siguruar fonde, RrGGK ka krijuar Fondin për Qëndrueshmërinë e RrGGK-së. Pagesat e anëtarësisë nga organizatat anëtare dhe anëtarët individual të RrGGK, si dhe organizimet për ngritjen e fondeve sikurse ishte Halloween Party i RrGGK-së që mbledhi 865.60€, që janë shumë të rëndësishme për këtë fond. Gjithashtu, stafi i RrGGK-së është trajnuar në shkrimin e projekt propozimeve të avancuara, dhe si rezultat stafi i RrGGK-së ka shkruar një projekt propozim i cili është përzgjedhur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe një projekt tjetër që për momentin është në shqyrtim.



“Ne mund t’ja dalim!” Halloween Party mbledhi 865.60€ për mbështetjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave.

Rritet bashkëpunimi mes grave në rajon (dhe më gjërë) drejt drejtësisë tranzicionale, paqes dhe sigurisë

RrGGK ka vazhduar rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me organizatat e grave nga rajoni dhe ndërkombëtare, posaqërisht lidhur me drejtësinë tranzicionale. Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGGK-së, është ftuar dhe kandiduar që të bëhet anëtare e Grupit të Ekspertëve Këshillues të Nivelit të Lartë për Studimin Global lidhur me implementimin 15 vjeçar të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) 1325. Ajo ka theksuar se duhet të ketë drejtësi dhe dënime për anëtarët e forcave paqeruajtëse të cilët gjatë misioneve janë përfshirë në trafikim dhe forma të tjera të dhunës në baza gjinore. Gjithashtu, para takimit ajo është takuar me aktiviste për të drejtat e grave nga rajoni, për t'u konsultuar mbi çështjet e ngritura më lartë.

RrGGK, Alternative Girl's Center nga Krushevac, Serbi dhe Association Dea Dia nga Kovacica, Serbi, të përkrahura nga Kvinna till Kvinna, organizuan Shkollën Verore Feministe si një iniciativë për ndërtimin e paqes për vajzat e reja. Nga 15 korriku deri me 21 korrik, Shkolla Verore tuboi 20 vajza nga Kosova dhe Serbia në Ohër, Maqedoni. Ato u njohtuan për historikun e lëvizjes feministe në botë dhe

“Kjo është hera e parë që pata mundësinë të takohem dhe në fakt të kem një bisedë të përzemërt me një vajzë shqiptare.”
- Pjesëmarrëse në Shkollën Verore Feministe





në Evropën Jug-Lindore; feminizmin dhe nacionalizmin; metodat e hulumtimit feminist; feminizmin e përditshëm; dhe gratë në media. Shkolla Verore Feministe krijoi afrime mes vajzave nga Serbia dhe Kosova, si dhe u ofroi atyre mjetet, idetë dhe kontaktet e nevojshme për iniciativa të përbashkëta në të ardhmen.

RrGGK gjithashtu ka bashkëpunuar me gratë nga rajoni mbi çështjet që lidhen me drejtësinë tranzicionale dhe të drejtat e lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinjorëve (LGBT).

RRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIM-MARRJE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendim-marrje në nivel komunal dhe kombëtar. RrGGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së kësaj objektive, siç paraqitet në arritjet dhe rezultatet e mëposhtme.

Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendim-marrje në nivel komunal dhe kombëtar

Në vitin 2014, RrGGK ka fuqizuar dhe ka inkurajuar më shumë gra të kandidojnë për pozita vendim-marrëse në nivel komunal dhe kombëtar.

Krijimi dhe funksionimi i Grupeve Avokuese për Barazi Gjinore si dhe i Lobit për Barazi Gjinore në nivel kombëtar.

RrGGK ka përkrahur krijimin e Grupeve të reja Avokuese për Barazi Gjinore (GABGj) në vitin 2014, duke e rritur numrin e grupeve në 17. Këto grupe bashkojnë më shumë se 140 gra nga shoqëria civile, asambletë komunale, zyrtare për barazi gjinore dhe burra. GABGj-të shërbejnë si platformë nëpër parti politike dhe ndarje sektoriale, duke bashkuar gratë dhe disa burra të avokojnë së bashku për të drejtat e grave në nivel komunal.

Përfaqësueset e pesëmbëdhjetë GABGj-ve u mbledhën në Durrës, Shqipëri me 28-30 mars, ku identifikuan qëllimet avokuese për komunat e tyre për vitin 2014. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së, vizitoi secilën GABGj, duke iu ofruar mbështetje dhe mentorim për iniciativat e tyre avokuese. RrGGK gjithashtu ka përkrahur shfaqjen e filmit “Engjujt e Hekurt”, i cili përmban mesazhe të rëndësishme për solidaritetin e grave për ndasit politike, fuqizimin e grave dhe strategjitë për avokim. Kjo gjithashtu është

“Ndjehemi shumë mirë që kemi pasur më shumë sukses se sa që kemi pritur, në iniciativat tona avokuese, por kjo nuk do të thotë që ne duhet të ndalemi të identifikojmë çështje të reja dhe të avokojmë për to.”

- Pjesëmarrëse

“Duke marrë parasysh rutinën e përditshme dhe sfidat me të cilat përballemi, definitivisht patëm nevojë që dikush të na kujtoj ‘të kthehemi mbrapa’, të bëhemi pozitive dhe të na demonstroj teknika të dobishme për ta bërë këtë.”

- Pjesëmarrëse

përkrahur nga institucionet lokale, përfshiu edhe kryetarët e komunave, të cilët morën pjesë në diskutime dhe ofruan hapësirat për shfaqjen e filmit.

Më vonë, me 26 deri me 27 qershor, përfaqësueset e GABGj-ve nga 15 komuna morën pjesë në takimin e dytë, të mbajtur në Brod, Dragash. Anëtarët e GABGj-ve raportuan për mbarëvajtjen e fushatave të avokimit

të përbashkët në komunat e tyre përkatëse. Edhe pse anëtarët e GABGj-ve kishin planifikuar t’i realizonin iniciativat e tyre avokuese deri në fund të vitit 2014, shumica prej komunave i realizuan ato iniciativa që në muajin qershor. Andaj, ato së bashku identifikuan qëllime të reja. Gjithashtu anëtarët e GABGj-ve

morën pjesë në punëtoritë: Fuqizimi dhe mendimi pozitiv; dhe metodat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Me 21 nëntor, 64 anëtare të GABGj-ve mbajtën takimin e tretë në Strugë, Maqedoni. Ato raportuan për arritjet e tyre avokuese në vitin 2014 (shih Aneksin 2), që u evidentuan si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë mes grave nga partitë e ndryshme politike dhe grave të shoqërisë civile në nivel komunal. Ato gjithashtu shtruan shembuj të ndryshëm të grave politikane të cilat ngritën çështje të rëndësishme për gratë votuese tek zyrtarët dhe anëtarët e asambleve.



Lobi për Barazi Gjinore i Kosovës, në Strugë, Maqedoni gjatë muajit nëntor

Gjatë këtij takimi, gratë nga sfera e politikës dhe shoqërisë civile nga 17 komuna, themeluan Lobin për Barazi Gjinore në Kosovë. Anëtarët vendosën që edhe burrat dhe djemtë të cilët përkrahin të drejtat e barabarta mes grave dhe burrave, të kenë mundësinë të jenë pjesë e grupit. Sipas deklaratës, anëtarët e Lobit “përkushtohen të punojnë së bashku drejt arritjes së barazisë gjinore në Kosovë, pa marrë parasysh preferencat politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësitë, fenë, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik”. Më tutje vazhdon: “Ne do të punojmë drejt përmbushjes së vizionit tonë të përbashkët për barazi gjinore nëpërmjet shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve, rrjetëzimit, avokimit dhe duke iu shërbyer nevojave të të gjithë qytetarëve të Kosovës”. Anëtarë të këtij lobi mund të jenë gra dhe burra, djem dhe vajza, nga gjithë Kosova, të cilët përkrahin vizionin e lobit. Të gjitha aktivitetet e GABGj-ve janë përkrahur nga ADA dhe Kvinna till Kvinna.

Politikat publike kanë ndryshuar me qëllim që të reflektojnë prioritetet e grave votuese

Në vitin 2014, avokimet e GABGj-ve të përkrahura nga RrGGK apo nga Fondi i Grave të Kosovës, arritën së paku 22 ndryshime në politika publike, të cilat u përmirësuan që të reflektojnë më mirë prioritetet e grave votuese në nivel komunal. Përveq kësaj, avokimet e aktivisteve për të drejtat e njeriut arritën të përmirësojnë gjashtë politika publike që të reflektojnë prioritetet e grave votuese në nivel kombëtar. Kjo përfshinë:

- 1) “Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë



luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre,” që mundëson njohjen e statusit të të mbijetuarëve të dhunës dhe të abuzimeve seksuale gjatë luftës. RrGGK e ka ngritur fillimisht këtë çështje në protestën e 8 Marsit në vitin 2012, si dhe ka avokuar për këtë ligj në muajt në vazhdim.

- 2) RrGGK dhe anëtarët e saj kanë kontribuar dhe përkrahur (bazuar në përvojat dhe nevojat e grave) Presidenten në krijimin e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale gjatë luftës.
- 3) Pas avokimit 10 vjeçar të RrGGK-së, në muajin shkurt qeveria ka aprovuar *Planin e Veprimeve për implementimin e rezolutës 1325 në Republikën e Kosovës*.
- 4) Qarkorja buxhetore për organizatat buxhetore qendrore për vitin 2015, përmban referenca për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe inkurajon përdorimin e saj, si rezultat i avokimit të RrGGK-së dhe GIZ tek Ministria e Financave.
- 5) Ministria e Financave ka përfshirë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH).
- 6) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu ka përfshirë barazinë gjinore dhe ka përmirësuar perspektivën gjinore brenda kapitullit të KASH-it me kontributin e RrGGK-së dhe GIZ-it.

Letrat avokuese të RrGGK në vitin 2014

RrGGK është përpjekur të sigurojë që të dëgjohet zëri i grave për çështje të rëndësishme duke shkruar letra dhe kumtesa për media (shih më lartë). Në vitin 2014, RrGGK ka shkruar katër letra drejtuar zyrtarëve mbi çështjet që janë të rëndësishme për gratë (dhe burrat) në Kosovë:

- Letër drejtuar z. Bernard Nikaj, U.D i Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, z. Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës, lidhur me përmasat shqetësuese të raportuara për përmbajtjen e sulfurit në naftën e nxemjes për shkollat fillore dhe të mesme të Prishtinës. (5 shkurt)
- RrGGK u bën thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të përkrahin ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre. (19 mars)
- Reagim lidhur me akuzat për abuzim seksual të pacientëve në Insitutin Special në Shtime (27 mars)
- Letër e hapur Drejtuar autorit të tekstit arsimor “Kriminalistika”, recensuesëve të librit “Kriminalistika”, Këshillit Botues, Dekanit të Fakultetit Juridik, dhe Prorektore për Arsim në Universitetin e Prishtinës lidhur me gjuhën e përdorur në kapitullin “Karakteristikat e Viktimave të Marrëdhënies Seksuale me Dhunë.” (21 tetor)
- Letër drejtuar deputetëve të parlamentit të Kosovës (19 dhjetor)

Gratë në politikë, OJQ-të e grave dhe gratë votuese kanë komunikuar dhe bashkëpunuar për çështjet që gratë i konsiderojnë si prioritete

Nëpërmjet GABGJ-ve dhe Fondit të Grave të Kosovës, RrGGK ka vazhduar komunikimin mbështetës në mesin e grave në politikë dhe në shoqërinë civile (siç dëshmojnë shembujt e lartpërmendur).

Buxheti i Kosovës reflekton më shumë prioritete të avokuara nga gratë

Këtë vit RrGGK ka bërë hulumtimin dhe ka shkruar *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale: Një Analizë e Shpejtë Gjinore për Informimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale* – raporti i parë i këtij lloji në Kosovë. Raporti përfshin një analizë të përfituesve të të gjitha departamenteve, divizioneve dhe njësive të tjera në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Ai pastaj shqyrton shumat buxhetore të alokuara për gratë dhe burrat përfitues, duke identifikuar fushat e pabarazisë. Gjetjet kontribuojnë tek të dhënat specifike për buxhetin e MPMS-së për 2015-2017. *Deutsche Gesellschaft für Internationale*



*Behxhet Gaxhiqi, Këshilltarë Politik i Ministrisë për
Çështje Sociale në Ministrinë e Punës dhe
Mirëqenies Sociale dhe Edona Hajrullahu,
Kryeshefe Ekzekutive në Agjencinë për Barazi
Gjinore mbajtën fjalim në linsimin e Buxhetimit
për Mirëqenie Sociale.*

Zusammenarbeit (GIZ) GmbH ka financuar raportin dhe RrGGK ka bashkëpunuar ngushtë me MPMS. Raporti është në dispozicion në faqen e internetit të RrGGK-së në anglisht, shqip dhe serbisht.

Si rezultat i bashkëpunimit të RrGGK-së dhe GIZ-it, shembuj të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor janë futur në qarkoret buxhetore për organizatat lokale dhe qendrore buxhetore; Komuna e Kamenicës ka përfshirë të dhëna të zbërthyer gjinore, indikatorë, objektiva dhe aktivitete në Kornizën e saj Afatmesme të Buxhetit. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përfshirë indikatorët e rinjë nga një perspektivë gjinore në Draft-Buxhetin e saj; perspektiva gjinore është përmendur në kapitujt e KASH-it për vitet 2015-2017 të MPMS-së dhe Ministrisë së Financave. Kështu, ndërsa buxheti i Kosovës për vitin 2015 ende nuk është miratuar, RrGGK ka sinjale nga MPMS dhe Komuna e Kamenicës se dokumentet e tyre buxhetore do të përfshijnë një perspektivë gjinore të përmirësuar.

Më tej, avokimi nga GABGJ dhe anëtarët e RrGGK gjithashtu ka fuqizuar disa ndryshime në linja të veçanta buxhetore në nivel komunal (shih Shtojcën 2).

Më shumë pjesëmarrje të grave në proceset vendimmarrëse që lidhen me paqen dhe sigurinë, sipas RKSOKB 1325

Edhe këtë vit, RrGGK ka qenë shumë aktive në diskutimet në lidhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së, Igballë Rogova, është ftuar shumë shpesh për t'u bashkuar me Grupin Këshillues të Ekspertëve të Nivelit të Lartë të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Studimin Global mbi zbatimin 15-vjeçar të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (shih gjithashtu Të arriturat 1.3). Nëpërmjet këtij Grupi Këshillues ajo e ka shpaluar përvojën e Kosovës dhe ka dhënë rekomandime në drejtim të përmirësimit të pjesëmarrjes së grave në proceset vendim-marrëse që lidhen me paqen dhe sigurinë. Lidhur me këtë çështje, ajo gjithashtu ka marrë pjesë në disa panele diskutuese të nivelit të lartë ndërkombëtar në vitin 2014 në Vjenë dhe Bruksel.

“Ne të gjitha biem dakord se fakti që Qarkorja Buxhetore 2015/01 për Komunitat inkurajon buxhetimin e përgjegjshëm gjinor është një lajm i mirë. Ne do të përdorim tregues me një perspektivë gjinore për të matur ndikimin e buxhetit mbi jetën e grave dhe burrave.”

- Anëtare e GABGj



PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESHIN SHËNDETËSOR CILËSOR

RrGGK ka përparuar dukshëm drejt objektivit të saj afat-gjatë që "gratë të kenë qasje të përbalueshme në kujdes shëndetësor cilësor."

Përmirësimi i qasjes së grave në kujdesin shëndetësor cilësor

Për fat të keq, përkundër përpjekjeve të shumta, RrGGK nuk ka mundur të sigurojë fonde për shumë aktivitete të planifikuara lidhur me këtë program (p.sh., për hulumtimin mbi qasjen e grave në kujdesin shëndetësor cilësor). Edhe kështu, fal punës së madhe të anëtareve të RrGGK, përfshirë edhe përmes Fondit të Grave të Kosovës, është bërë pak përparim drejt këtij rezultati, siç demonstronhet nga rezultatet e mëposhtme.

Më shumë gra dhe vajza të vetëdijësuar për të drejtat e tyre dhe për rëndësinë e qasjes në kujdes shëndetësor; më shumë gra të vetëdijësuar si të zbulojnë shenjat e kancerit

Grantet e dhëna nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës kanë mbështetur përpjekjet e shumta për të avancuar njohuritë e grave në lidhje me kujdesin shëndetësor. Është ngritur vetëdija e më shumë se 1035 grave lidhur me shëndetin e tyre nëpërmjet granteve mbështetëse të Fondit të Grave të Kosovës gjatë vitit 2014. Për shembull, OJQ Luna ka organizuar ligjërata nga gjinekologu dhe ka nisur një program arsimor për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje për gratë nga komunitetet rome dhe serbe. OJQ Gruaja Hyjnore dhe Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes kanë ndërmarr një iniciativë të përbashkët të fokusuar në integrimin

Përveç kësaj, të paktën 727 gra kanë pasur qasje në kujdesin shëndetësor me mbështetjen e anëtareve të RrGGK-së në vitin 2014. Vita-Jeta ka ofruar kontrolla falas për osteoporozën për 606 gra, kryesisht pensioniste të cilat nuk mund të përballojnë ndryshe rentgene të tilla. Gjatë kësaj iniciative, gratë kanë nënshkruar një peticion të cilin ato do ta përdorin së bashku me Vita-Jeta për të avokuar në zbatimin e Ligjit për Shëndetësi në vitin 2015. Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave kanë ofruar këshillim dhe përkrahje të grupeve të grave që kanë mbijetuar dhunën seksuale gjatë luftës në Komunën e Skenderajt.



*Vita Jeta ofron kontrollë fala të osteoporozës
pë gratë, dhe në të njëjtën kohë i përfshinë
ato për të avokuar për të drejtën e tyre në
kuides cilësor shëndetësor.*

JETA PA DHUNË NË FAMILJE DHE TRAFIKIM

Pasi që RrGGK ka bërë përpjekje intensive në këtë drejtim në vitet e mëparshme, këtë vit Rrjeti është fokusuar më shumë në programet tjera më pak të trajtuara, në drejtim të zbatimit të plotë të Planit Strategjik për vitet 2011-2014. Megjithatë, disa veprime janë ndërmarrë drejt objektivit afat-gjatë që gratë të jetojnë një jetë pa trafikim dhe dhunë në familje.

Rritet vetëdija publike për legjislacionin dhe mënyrat se si të kërkohet ndihma

Rezultatet në vijim tregojnë progresin për këto të arritura.

Më shumë burra dhe gra të informuar mbi legjislacionin

Përsëri këtë vit, Një Milion në Këmbë në Kosovë *One Billion Rising Kosova* mblodhi burrat dhe gratë në fushatën “Çohuni, Vallëzoni dhe Kërkoni”, një ngjarje në rrugë në platonë afër Hotel Grandit në Prishtinë. Të premtën, me 14 shkurt burra dhe gra bënë thirrje për të ndalur dhunën ndaj grave dhe vajzave. Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga dhe stafi i saj gjithashtu morën pjesë në këtë ngjarje.

Gjithashtu, me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës, *Femrat Aktive të Gjakovës* organizoi seanca informuese lidhur me dhunën në familje dhe ka monitoruar Strategjinë e Komunës së Gjakovës për këtë çështje. Kjo iniciativë rezultoi në një rritje të numrit të rasteve të raportuara ekzistuese. Ajo gjithashtu ka

kontribuar në përmirësimin e nivelit të efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjësisë së grupit koordinues që ofron ndihmë, parandalim, mbrojtje dhe ri-integrim në rastet e dhunës në familje.

Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës, OJQ *Venera* ka ngritur vetëdijen tek gratë që kanë përjetuar dhunë në familje, duke fuqizuar ato që të kërkojnë të drejtat e tyre të garantuara me ligj. Ato ndihmuan gratë në qasjen e institucioneve përgjegjëse për adresimin e kësaj çështje; dhe në avokimin tek institucionet përkatëse. Ato gjithashtu monitoruan seanca lidhur me rastet e dhunës në familje, si dhe rastet gjyqësore në trashëgimi dhe shkurorëzim në Gjykatën Themelore në Pejë. Ato avokuan te autoritetet për të trajtuar këto raste me seriozitet dhe drejtësi. Të dyja këto nisma të mbështetura nga RrGGK kanë kontribuar në rritjen e zbatimit të ligjit dhe strategjisë në nivel komunal.



Vajzat dhe djemtë ngrihen kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave në “Një Milion në Këmbë” (One Billion Rising) me 14 shkurt, në Prishtinë.

MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE

RrGGK bën përpjekje të vazhdueshme drejt objektivës së saj afat-gjatë që gratë të kenë qasje të barabartë në punësim në Kosovë.

Përmirësohet gradualisht pozita ekonomike e grave në Kosovë

Duke pasur parasysh punën e RrGGK-së në këtë fushë dhe analizën e situatës, anëtarët e RrGGK vendosën që të fokusohen më shumë në avokim dhe politika, se sa në zhvillimin e bizneseve. Ky vendim është bazuar për faktin që tashmë në Kosovë egzistojnë disa programe që i përkrahin gratë në zhvillimin e bizneseve të tyre. Për më shumë, edhe Oda e re Ekonomike e Grave poashtu do të fokusohet në këtë prioritet. Prapë se prapë, RrGGK kishte disa arritje që çuan më tutje drejt realizimit të kësaj objekte në vitin 2014, siç tregohet në rezultatet e mëposhtme.



Me përkrahje të Fondit të Grave të Kosovës, Shoqata Iniciativa e Grave ka përkrahur vajzat përmes trajnimeve për aftësi profesionale dhe për avokim tek Kryetari i Komunës së Dragashit për punësim. Si rezultat, 24 gra tani janë punësuar në fabrikën e re.

Shumë gra aftësohen që të zhvillojnë dhe të menaxhojnë me sukses bizneset e tyre

Përmes Fondit të Grave të Kosovës, gjatë vitit 2014, dy organizata anëtare të RrGGK-së morën përkrahje drejt fuqizimit ekonomik të grave: Iniciativa për Fuqizimin e Grave dhe OJQ Gora. Iniciativa për Fuqizimin e Grave organizoi kurse profesionale të rrobaqepësisë për gratë. Më pas, si rezultat i avokimit të tyre, 24 u punësuan në fabrikën e hapur së voni në Dragash. OJQ Gora ushtroi së paku 17 gra nga Dragashi dhe Prishtina se si të identifikojnë tregun dhe të sigurojnë qasjen në to për produktet e tyre të punëdotes. Ato morën pjesë në një panair të organizuar në Prishtinë dhe përfituan ekonomikisht nga shitja e produkteve të tyre. OJQ Top Radio përmes trajnimeve dhe avokimit ka arritur të ndihmoj gratë pjesëmarrëse në iniciativën e kësaj organizate të hapin pesë biznese formale.

Përmirësohet qasja e grave në prona (dhe kështu edhe në kapital), në përputhje me të drejtat e tyre ligjore

RrGGK është përpjekur shumë drejt përmirësimit të qasjes së grave në pronë dhe trashëgimi. Gjatë vitit 2014, përpjekjet u fokusuan në planifikim dhe krijimin e bazës për përpjekje për ngritjen e vetëdijes dhe për përkahje në të ardhmen, siç është planifikuar në Strategjinë e RrGGK 2015-2018.



Qytetarët vetëdijësohen për të drejtat e grave në trashëgimi dhe pronë

RrGGK iu bashkangjiti fushatës "Për të Mirën Tonë" nën patronatin e Zyrës së Presidentes së Kosovës, mbështetur nga GIZ, USAID, Gratë për Gratë International, Shoqata e Grave Juriste Norma, OSBE, SHE-ERA, G7, SHPRK, Shoqata e Bankave të Kosovës, Oda Ekonomike e Grave të Kosovës dhe Shoqata e Kosovës për Gjeodezi. Kjo fushatë synon të përmirësojë barazinë gjinore në regjistrimin e pronës. Si pjesë e kësaj fushate, 75 anëtare të RrGGK nënshkruan një deklaratë për të punuar me anëtarët e tyre të stafit dhe familjeve për të regjistruar pronën në emër të grave.

RrGGK gjithashtu ka kërkuar të bashkëpunojë me Zyrën Kadastrale dhe Bankën Botërore; USAID/TetraTech; konsorciumin e udhëhequr nga GIZ të mbështetur nga Bashkimi Evropian për Mbështetjen e Kodit Civil dhe të Drejtave Pronësore; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe USAID/Chemonics për të mbështetur regjistrimin e pronave të paligjshme; dhe OSBE-së. RrGGK ka shpenzuar kohë për koordinim që të sigurohet që nevojat e anëtareve të saj dhe grave të cilave u shërben të konsiderohen në këto projekte.

Përveç kësaj, përmes Fondit të Grave të Kosovës dy organizata anëtare të RrGGK kanë marrë mbështetje për punën e tyre drejt qasjes së grave në të drejtat e pronësisë: Partners Kosova dhe Shoqata e Grave Juriste Norma. Partners Kosova ka mbajtur takime me Zyrtarët për Barazi Gjinore dhe gratë dhe burrat nga Lipjani, Skenderaji, Drenasi dhe Ferizaji për ti informuar ata në lidhje me "të drejtat e grave në ndarjen e pronës dhe trashëgimisë". Në total, 109 gra dhe vajza, si dhe 34 burra dhe djem morën informata se si të avokojnë për të drejtën e gruas në pronë dhe trashëgimi.



